**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
*Ministry of Environment and Spatial Planning*
*Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja*

**AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS** | **KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE** | **KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY**

# UDHËZUES

PËR INVENTARIZIMIN E TRUNGJEVE TË VJETRA SI MONUMENTE TË NATYRËS ME KARAKTER BOTANIK DHE MONUMENTE TË ARKITEKTURËS SË PARKUT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS



**Përmbajtja**

1. KAPITULLI I. HYRJE
2. KAPITULLI II. BAZA LIGJORE
3. KAPITULLI III. PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE
4. KAPITULLI IV. KRITERET PËR IDENTIFIKIMIN E TRUNGJEVE TË VJETRA
5. KAPITULLI V METODOLOGJIA E INVENTARIZIMIT
6. Shtojca 1.
   FORMULARI STANDARD I INVENTARIZIMIT DHE STRUKTURA E TË DHËNAVE

# KAPITULLI I. HYRJE

## 1.1 Sfondi

Trungjet e vjetra përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë natyrore të Republikës së Kosovës. Ato janë dëshmitarë të proceseve natyrore, historisë së peizazhit dhe zhvillimit të vendbanimeve, duke bartur njëkohësisht vlera të larta ekologjike, biologjike, shkencore, kulturore, historike dhe estetike.

Trungjet monumentale dhe trungjet e vjetra krijojnë habitate për një numër të madh organizmash, përfshirë shpendë, gjitarë të vegjël, insekte, kërpudha, likene dhe myshqe. Për shkak të përmasave të tyre, moshës shumëvjeçare dhe karakteristikave të veçanta biologjike, ato konsiderohen elemente me rëndësi të veçantë për ruajtjen e biodiversitetit. Në zonat urbane, trungjet e vjetra kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, zbutjen e efektit të ishullit të nxehtësisë, rregullimin e mikroklimës, reduktimin e zhurmës, thithin pluhurat dhe blozën, ndihmojnë në reduktimin e smogut nga trafiku, neutralizojnë gazrat dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Shumë prej tyre janë të lidhura me ngjarje historike, monumente kulturore, objekte fetare ose tradita lokale, duke shtuar vlerën e tyre si pjesë e identitetit të komunitetit.

Megjithatë, urbanizimi, zhvillimi i infrastrukturës, ndryshimet klimatike, dëmtimet mekanike, sëmundjet dhe mungesa e menaxhimit sistematik kanë rritur presionin mbi këto vlera natyrore. Për këtë arsye, identifikimi dhe inventarizimi i tyre përbën hapin e parë dhe më të rëndësishëm drejt mbrojtjes dhe menaxhimit afatgjatë.

Udhëzuesi për Inventarizimin e trungjeve të vjetra si Monumente të natyrës me karakter botanik dhe Monumente të arkitekturës së parkut (trungje të vjetra urbane) në Republikën e Kosovës është i bazuar edhe në përvojën dhe praktiken të cilën Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës e ka aplikuar me rastin e evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore, respektivisht Monumenteve te natyrës në territorin e Kosovës të cilat gëzojnë statutin e vlerave të mbrojtura të natyrës.

## 1.2 Qëllimi i udhëzuesit

Ky udhëzues është hartuar për të standardizuar procedurat e inventarizimit të trungjeve të vjetra në Republikën e Kosovës, duke siguruar një metodologji të njëjtë për të gjitha komunat dhe institucionet përgjegjëse.
Qëllimet kryesore janë:

- identifikimi sistematik i trungjeve të vjetra me vlera botanike, ekologjike, historike dhe kulturore;
- krijimi i një metodologjie të unifikuar për inventarizimin në nivel kombëtar;
- krijimi i bazës kombëtare të të dhënave për trungjet e vjetra;
- mbështetja e procedurave për shpalljen e monumenteve të natyrës;
- mbështetja e planifikimit hapësinor dhe urban;
- sigurimi i të dhënave për menaxhimin dhe monitorimin afatgjatë;
- harmonizimi i praktikave të inventarizimit me standardet ndërkombëtare.

## 1.2 Objektivat

Ky udhëzues synon të:

- përcaktojë kriteret për identifikimin e trungjeve të vjetra;
- standardizojë metodat e matjes në terren;
- përcaktojë parametrat biologjikë dhe dendrometrikë që duhet të regjistrohen;
- standardizojë dokumentimin fotografik dhe gjeohapësinor;
- krijojë formularë të unifikuar për mbledhjen e të dhënave;
- sigurojë krahasueshmëri ndërmjet inventarëve të realizuar nga komuna të ndryshme;
- mundësojë integrimin e të dhënave në sistemet kombëtare të informacionit mjedisor.

## 1.3 Fushëveprimi

Ky udhëzues zbatohet për inventarizimin e:

- trungjeve të vjetra që paraqesin vlera të veçanta botanike dhe mund të propozohen për shpallje si monumente të natyrës;
- trungjeve të vjetra urbane në prona publike dhe private, kur ato paraqesin interes publik;
- trungjeve individuale me dimensione të jashtëzakonshme;

- grupeve të vogla të trungjeve me rëndësi të veçantë;
- trungjeve me rëndësi historike, kulturore ose memoriale.

Ky udhëzues nuk zbatohet për inventarizimin e pyjeve ekonomike, plantacioneve pyjore, pemishteve prodhuese dhe sipërfaqeve të menaxhuara për prodhim drusor.

### 1.4 Përdoruesit e udhëzuesit

Ky dokument është i dedikuar për:

- ministrinë përgjegjëse për mjedisin;
- agjencinë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
- komunat e Republikës së Kosovës;
- institucionet përgjegjëse për planifikimin hapësinor;
- institucionet e trashëgimisë kulturore;
- institucionet kërkimore dhe akademike;
- ekspertët e pylltarisë, hortikulturës, dendrologjisë dhe biologjisë;
- organizatat që merren me mbrojtjen e natyrës.

### 1.6 Parimet themelore

Inventarizimi i trungjeve të vjetra duhet të bazohet në këto parime:

- ligjshmëria;
- objektiviteti shkencor;
- transparenca;
- standardizimi metodologjik;
- saktësia e matjeve;
- verifikueshmëria e të dhënave;
- mbrojtja e biodiversitetit;
- përdorimi i teknologjive bashkëkohore GIS dhe GPS;
- monitorimi i vazhdueshëm dhe përditësimi periodik i inventarit.

# KAPITULLI II. BAZA LIGJORE

## 2.1 Qëllimi i bazës ligjore

Inventarizimi i trungjeve të vjetra si monumente të natyrës me karakter botanik dhe i trungjeve të vjetra urbane mbështetet në legjislacionin e Republikës së Kosovës që rregullon mbrojtjen e natyrës, mjedisit, planifikimin hapësinor dhe kompetencat e vetëqeverisjes lokale.
Baza ligjore përcakton:

- kompetencat e institucioneve;
- procedurat për identifikimin dhe mbrojtjen e vlerave natyrore;
- detyrimet për inventarizim dhe monitorim;
- menaxhimin e të dhënave mjedisore;
- integrimin e vlerave natyrore në planifikimin hapësinor.

## 2.2 Legjislacioni kryesor

**Ligji për Mbrojtjen e Natyrës-** Ligji kryesor

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës përbën bazën kryesore juridike për identifikimin, inventarizimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e monumenteve të natyrës në Republikën e Kosovës.
Ky ligj përcakton:

- kategoritë e zonave të mbrojtura;
- monumentet e natyrës;
- procedurat për shpallje;
- detyrimet për inventarizim;
- monitorimin e gjendjes së vlerave natyrore;
- rolet e ministrisë, agjencisë dhe komunave.

Për udhëzuesin tonë, ky është ligji më i rëndësishëm.
Trungjet e vjetra me vlera të veçanta botanike mund të propozohen për shpallje si Monument Natyror sipas dispozitave të këtij ligji.

**Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit**
Korniza mjedisore

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme të mbrojtjes së mjedisit dhe detyrimet e institucioneve për ruajtjen e resurseve natyrore.
Rëndësia për inventarizimin:

- krijimi i bazave të të dhënave mjedisore;
- monitorimi i gjendjes së mjedisit;
- qasja në informacion mjedisor;
- planifikimi dhe raportimi.

**Ligji për Planifikimin Hapësinor**
Integrimi në plane

Vlerat natyrore të identifikuara përmes inventarizimit duhet të integrohen në dokumentet e planifikimit hapësinor.
Komunat duhet të sigurojnë që:

- trungjet e mbrojtura të evidentohen në planet komunale;
- projektet zhvillimore të marrin parasysh këto vlera;
- të shmangen ndërhyrjet që rrezikojnë trungjet monumentale.

**Ligji për Vetëqeverisjen Lokale**
Kompetencat komunale

Ky ligj përcakton kompetencat e komunave në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të hapësirës publike.
Komunat kanë përgjegjësi për:

- inventarizimin lokal;
- mbrojtjen e hapësirave të gjelbra;
- mirëmbajtjen e trungjeve urbane;
- propozimin e vlerave për mbrojtje.

**Legjislacioni për Trashëgiminë Kulturore**
Kur ka vlerë historike dhe kulturore

Kur një trung i vjetër lidhet me ngjarje historike, objekte kulturore ose tradita lokale, duhet të merret parasysh edhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore.

### 2.3 Aktet nënligjore

Për zbatimin e këtij udhëzuesi duhet të merren parasysh edhe:

- udhëzimet administrative të ministrisë përgjegjëse për mjedisin;
- rregulloret për zonat e mbrojtura;
- standardet për menaxhimin e hapësirave të gjelbra;
- aktet komunale për gjelbërimin urban.

### 2.4 Detyrimi për inventarizim

Institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë

- identifikimin sistematik të trungjeve me vlera të veçanta;
- mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave;
- përditësimin periodik të inventarit;
- raportimin tek institucionet qendrore;
- qasshmërinë e të dhënave sipas legjislacionit në fuqi.

### 2.5 Procedura për shpalljen e Monumentit të Natyrës

Inventarizimi përbën hapin e parë teknik në procesin e mbrojtjes ligjore të një trungu të vjeter.
Procedura e përgjithshme përfshin:

1. Identifikimin e trungut.
2. Inventarizimin dhe dokumentimin.
3. Vlerësimin profesional.
4. Përgatitjen e propozimit për mbrojtje.
5. Shqyrtimin nga institucionet kompetente.
6. Shpalljen zyrtare sipas procedurave ligjore.

### 2.6 Standardet dhe praktikat ndërkombëtare

Edhe pse udhëzuesi bazohet në legjislacionin e Kosovës, rekomandohet harmonizimi me praktikat e:

| Institucioni / Organizata | Relevanca |
|---|---|
| IUCN | Kategoritë e mbrojtjes dhe menaxhimi i vlerave natyrore |
| FAO | Metodat e inventarizimit dhe dendrometrisë |
| European Environment Agency | Menaxhimi i të dhënave mjedisore dhe GIS |

Çdo aktivitet inventarizimi i realizuar sipas këtij udhëzuesi duhet të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe të shërbej si bazë për mbrojtjen, menaxhimin dhe monitorimin afatgjatë të trungjeve të vjetra.

# KAPITULLI III. PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

## 3.1 Qëllimi

Ky kapitull përcakton përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në procesin e inventarizimit, verifikimit, menaxhimit dhe raportimit të të dhënave për trungjet e vjetra në Republikën e Kosovës.
Qartësimi i kompetencave institucionale është i domosdoshëm për të siguruar:

- zbatim të njëtrajtshëm të metodologjisë;
- shmangie të mbivendosjes së kompetencave;
- cilësi dhe besueshmëri të të dhënave;
- koordinim ndërinstitucional;
- mbrojtje efektive të vlerave natyrore.

## 3.2 Ministria përgjegjëse për mjedisin
**Kompetencat kryesore**

Nivel qendror

- harton politikat kombëtare për mbrojtjen e natyrës;
- miraton metodologjinë e inventarizimit;
- koordinon inventarin kombëtar të trungjeve të vjetra;
- siguron harmonizimin me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare;
- mbikëqyr zbatimin e udhëzuesit nga institucionet vartëse dhe komunat;
- inicioni procedurat për shpalljen e monumenteve të natyrës;
- siguron burime financiare dhe mbështetje teknike sipas mundësive buxhetore.

Ministria është autoriteti kryesor në hartimin e politikave dhe është rregullator për procesin e inventarizimit dhe mbrojtjes së trungjeve me vlera të veçanta.

### 3.3 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit
### Detyrat operative

Koordinim teknik
Agjencia përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit ushtrom funksionet teknike dhe operative:

- administron bazën kombëtare të të dhënave;
- pranon dhe verifikon të dhënat nga komunat;
- kontrollon cilësinë e inventarëve;
- siguron standardizimin e kodifikimit dhe formatit të të dhënave;
- përgatit raporte kombëtare periodike;
- ofron mbështetje për komunat me udhëzime teknike;
- koordinon integrimin e të dhënave në sistemet GIS kombëtare.

### 3.4 Komunat- roli në terren

Komunat janë institucionet kryesore për zbatimin e inventarizimit në terren.
Përgjegjësitë e komunave përfshijnë:

- organizimin e ekipeve të inventarizimit;
- planifikimin e punës në terren;
- mbledhjen e të dhënave sipas formularëve standardë;
- sigurimin e pajisjeve të nevojshme;
- verifikimin fillestar të të dhënave;
- ruajtjen e inventarit lokal;
- raportimin tek Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit;
- propozimin e trungjeve për mbrojtje ligjore;
- integrimin e të dhënave në planet komunale.

Çdo komunë rekomandohet të caktojë një person përgjegjës për koordinimin e inventarit të trungjeve të vjetra.

### 3.5 Institucionet shkencore dhe akademike
### Mbështetja profesionale

Ekspertizë
Universitetet, institutet kërkimore dhe ekspertët e fushës ofrojnë mbështetje profesionale për:

- identifikimin e specieve drunore;
- vlerësimin dendrologjik;
- vlerësimin e moshës së trungjeve;
- analizat fitosanitare;
- vlerësimin e vlerave ekologjike;
- hartimin e ekspertizave për shpallje të monumenteve të natyrës.

### 3.6 Institucionet e trashëgimisë kulturore

Kur një trung i vjetër ka lidhje me objekte ose ngjarje me rëndësi kulturore, institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore duhet të përfshihen në:

- vlerësimin historik dhe kulturor;
- dokumentimin e lidhjes me trashëgiminë kulturore;
- koordinimin e masave të mbrojtjes;
- integrimin në regjistrat përkatës.

### 3.7 Organizimi i ekipit të inventarizimit
### Përbërja e rekomanduar

Koordinator i ekipit
Ekspert i pylltarisë / dendrologjisë
Ekspert i GIS/GPS
Teknik për matje dendrometrike
Asistent për dokumentim fotografik dhe administrativ

Për inventarizime më komplekse mund të përfshihen edhe biologë, arboristë ( specialisti profesional për kujdesin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e drurëve, veçanërisht të drurëve të lartë dhe atyre që rriten në mjedise urbane, parqe, kopshte dhe zona të mbrojtura) dhe ekspertë të trashëgimisë kulturore.

### 3.8 Kompetencat e ekipit në terren

| Funksioni | Përgjegjësia |
|---|---|
| Koordinatori | Organizon punën dhe miraton formularët |
| Eksperti dendrologjik | Identifikon speciet dhe vlerëson gjendjen |
| Tekniku i matjeve | Kryen matjet e DBH, lartësisë dhe kurorës |
| Eksperti GIS/GPS | Regjistron koordinatat dhe të dhënat hapësinore |
| Asistenti | Dokumenton fotografitë dhe plotëson të dhënat ndihmëse |

### 3.9 Rrjedha institucionale e raportimit

Ekipi i inventarizimit
Drejtoria komunale përgjegjëse
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit
Ministria përgjegjëse për mjedisin

### 3.10 Afatet e raportimit

| Aktiviteti | Afati i rekomanduar |
|---|---|
| Dorëzimi i formularëve nga ekipi | 5 ditë pune |
| Verifikimi komunal | 10 ditë pune |
| Dërgimi në Agjenci | 15 ditë pune |
| Verifikimi nga Agjencia | 30 ditë pune |
| Përfshirja në bazën kombëtare | 45 ditë pune |

### 3.11 Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave
### Përgjegjësi ligjore dhe profesionale

Institucioni që realizon inventarizimin mban përgjegjësi për:

- saktësinë e matjeve;
- identifikimin korrekt të specieve;
- saktësin e koordinatave;
- plotësimin e formularëve;
- ruajtjen e dokumentacionit origjinal.

Çdo ndryshim i mëvonshëm në të dhënat e inventarit duhet të dokumentohet dhe të arsyetohet me procesverbal përkatës.
Zbatimi i qartë i përgjegjësive institucionale siguron që inventarizimi i trungjeve të vjetra të kryhet në mënyrë profesionale, të standardizuar dhe të verifikueshme, duke krijuar bazë të besueshme për mbrojtjen ligjore dhe menaxhimin afatgjatë të këtyre vlerave natyrore.

# KAPITULLI IV. KRITERET PËR IDENTIFIKIMIN E TRUNGJEVE TË VJETRA

## 4.1 Qëllimi

Ky kapitull përcakton kriteret teknike dhe profesionale për identifikimin e trungjeve të vjetra që duhet të përfshihen në inventarizim dhe që potencialisht mund të propozohen për mbrojtje si monumente të natyrës me karakter botanik ose si trungje urbane me vlera të veçanta.
Kriteret synojnë të sigurojnë përzgjedhje të njëtrajtshme në të gjitha komunat dhe të mundësojnë krahasueshmërinë e të dhënave në nivel kombëtar.

## 4.2 Parimet e përzgjedhjes

Një trung i vjetër përfshihet në inventar kur plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- moshë e avancuar;
- dimensione të jashtëzakonshme;
- vlera botanike;
- vlera ekologjike;
- vlera peizazhore;
- vlera historike;
- vlera kulturore ose memoriale;
- rrallësi në nivel lokal ose kombëtar.

## 4.3 Kriteri i moshës

**Pragu orientues**

≥ 100 vjet
Si kriter orientues, inventarizohen trungjet me moshë të vlerësuar 100 vjet e më shumë.
Për specie me rritje të ngadaltë, mund të përfshihen edhe ekzemplarë më të rinj nëse:

- kanë dimensione të jashtëzakonshme;
- janë të rrallë;
- kanë rëndësi historike ose kulturore.

Vlerësimi i moshës bëhet përmes:

- të dhënave historike;
- dokumenteve arkivore;
- intervistave me komunitetin lokal;
- analizës dendrologjike;
- modeleve të rritjes sipas specieve.

### 4.4 Kriteri i dimensioneve

Dimensionet maten në lartësinë standarde 1.30 m mbi nivelin e tokës (DBH).
Pragjet orientuese sipas madhësisë së trungut

| Kategoria | Diametri minimal |
|---|---|
| Shumë i madh | 150 cm |
| Monumental | 200 cm |
| Jashtëzakonisht monumental | 300 cm |

Për specie me përmasa natyrisht më të vogla, pragu mund të ulet me vlerësim profesional.

### 4.5 Kriteri i lartësisë

Inventarizohen edhe trungjet që paraqesin lartësi të pazakonshme për specien dhe rajonin përkatës.
Shembuj orientues

| Specia / grupi | Lartësia e konsiderueshme |
|---|---|
| Dushqet | 25 m |
| Ahishtet | 30 m |
| Pishat | 30 m |
| Platanet | 25 m |
| Bliret | 25 m |

### 4.6 Kriteri i vlerave botanike

Një trung përfshihet në inventar nëse:

- i përket një specieje autoktone me rëndësi të veçantë;
- i përket një specieje relikte;
- është ekzemplar i rrallë në Kosovë;
- ka karakteristika gjenetike të veçanta;
- përfaqëson ekzemplar me rëndësi për studime shkencore.

### 4.7 Kriteri i vlerave ekologjike

Vlerësohet rëndësia e trungut si habitat për organizma të tjerë.
Treguesit kryesorë

- zgavra natyrore;
- fole shpendësh;
- prania e lakuriqëve të natës;
- likene dhe myshqe të rralla;
- kërpudha me rëndësi ekologjike;
- trungje të vdekur në këmbë me vlerë habitatore.

Sa më i lartë numri i mikrohabitateve, aq më e lartë konsiderohet vlera ekologjike.

### 4.8 Kriteri i vlerave historike dhe kulturore

Trungjet inventarizohen kur lidhen me:

- ngjarje historike;
- personalitete të njohura;
- objekte fetare;
- qendra tradicionale të fshatit;
- rrugë historike;
- tradita lokale;
- kujtesë kolektive të komunitetit.

### 4.9 Kriteri i vlerës peizazhore

Vlerësohen:

- dominimi vizual në peizazh;
- forma karakteristike e kurorës;
- pozicioni në hapësirë;
- kontributi në identitetin e vendit;
- rëndësia estetike.

### 4.10 Kriteret specifike për trungjet urbane

Kushtet për inventarizim urban- mjafton një kriter
Në zonat urbane një trung inventarizohet nëse plotëson të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

- Moshë > 80 vjet
- Diametër > 100 cm
- Vlerë historike ose memoriale
- Rëndësi të veçantë për peizazhin urban
- Specie të rrallë në qytet
- Funksion të rëndësishëm ekologjik urban

### 4.11 Kriteret për përjashtim

Nuk përfshihen në inventar, përveç rasteve me rëndësi të veçantë:

- pemët e plantacioneve prodhuese;
- pemët frutore të zakonshme pa vlera të veçanta;
- ekzemplarët me moshë dhe dimensione të zakonshme;
- pemët e mbjella rishtazi;
- drurët pa vlera të identifikuara botanike, ekologjike, historike ose peizazhore.

### 4.12 Sistemi orientues i pikëzimit

| Kriteri | Pikët maksimale |
|---|---|
| Mosha | 25 |
| Diametri / përmasat | 25 |
| Vlera botanike | 15 |
| Vlera ekologjike | 15 |
| Vlera historike / kulturore | 10 |
| Vlera peizazhore | 10 |
| Gjithsej | 100 |

### Interpretimi i rezultatit

| Rezultati | Kategoria |
|---|---|
| 80–100 | Vlerë kombëtare |
| 60–79 | Vlerë rajonale |
| 40–59 | Vlerë komunale |
| < 40 | Inventar lokal orientues |

### 4.13 Prioritetet e inventarizimit

Kur resurset janë të kufizuara, prioritet kanë:

- trungjet me rrezik të lartë dëmtimi;
- trungjet me dimensione monumentale;
- trungjet pranë projekteve infrastrukturore;
- trungjet me vlera të dokumentuara historike;
- speciet e rralla ose të kërcënuara.

Kriteret e përcaktuara në këtë kapitull duhet të përdoren si bazë për përzgjedhjen e të gjitha trungjeve që do të inventarizohen në territorin e Republikës së Kosovës, duke siguruar qasje të standardizuar dhe të krahasueshme në nivel kombëtar.

# KAPITULLI V METODOLOGJIA E INVENTARIZIMIT

## 5.1 Qëllimi i metodologjisë

Metodologjia e inventarizimit përcakton procedurat standarde për identifikimin, matjen, dokumentimin dhe vlerësimin e trungjeve të vjetra me karakter botanik dhe trungjeve të vjetra urbane.
Qëllimi është që të sigurohen të dhëna:

- të sakta;
- të krahasueshme;
- të verifikueshme;
- të përshtatshme për përdorim në sistemet GIS;
- të përdorshme për vendimmarrje institucionale.

Inventarizimi duhet të realizohet nga ekipe të trajnuara duke përdorur metoda të njëjta në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

## 5.2 Fazat e inventarizimit

Procesi i inventarizimit ndahet në pesë faza kryesore:

1. Përgatitja dhe planifikimi
2. Identifikimi paraprak
3. Puna në terren
4. Përpunimi dhe verifikimi i të dhënave
5. Regjistrimi dhe raportimi

## 5.3 Faza I – Përgatitja dhe planifikimi

Para daljes në terren duhet të kryhen aktivitetet përgatitore.

### *5.3.1 Krijimi i ekipit të inventarizimit*

Komuna ose institucioni përgjegjës cakton ekipin teknik i cili duhet të përfshijë, sipas nevojës:

- ekspert të pylltarisë ose dendrologjisë;
- ekspert të biodiversitetit;
- ekspert GIS;

- teknik për matje;
- person përgjegjës për dokumentim.

*5.3.2 Mbledhja e informacionit ekzistues*

Para punës në terren analizohen:

- hartat topografike;
- ortofotot;
- hartat kadastrale;
- planet urbane;
- inventarët ekzistues komunalë;
- të dhënat nga banorët lokalë;
- literatura shkencore;
- dokumentet historike.

*5.3.3 Përgatitja e materialeve të punës*

Ekipi duhet të ketë:

- formularët standardë;
- harta pune;
- listën paraprake të trungjeve;
- pajisjet matëse;
- pajisjet GPS;
- aparatin fotografik ose tabletin;
- mjete sigurie personale.

**5.4 Faza II – Identifikimi paraprak**

Identifikimi paraprak bëhet përmes:

*Burimeve teknike*

- analizës së imazheve satelitore;
- ortofotove;
- hartave të gjelbërimit urban;
- databazave ekzistuese.

*Burimeve lokale*

- informacioneve nga banorët;
- administratës komunale;

- pronarëve të tokave;
- organizatave mjedisore;
- ekspertëve lokalë.

**5.5 Faza III – Puna në terren**

Puna në terren është faza kryesore e inventarizimit.
Për çdo trung krijohet një regjistrim unik.

*5.5.1 Kodi identifikues i trungut*

Çdo trung pajiset me një kod unik.
Shembull: **KS-PR-001-2026** ku:

- KS = Kosovë
- PR = kodi i komunës
- 001 = numri rendor
- 2026 = viti i inventarizimit

Kodi duhet të jetë unik dhe të përdoret në të gjitha dokumentet.

*5.5.2 Identifikimi i vendndodhjes*

Regjistrohen:

- komuna;
- zona kadastrale;
- fshati/qyteti;
- parcela kadastrale;
- pronësia;
- adresa (për trungjet urbane);
- koordinatat GPS.

*5.5.3 Regjistrimi i koordinatave*

Koordinatat duhet të regjistrohen me pajisje GPS ose aplikacion GIS.
Rekomandohet përdorimi i sistemit:
**ETRS89 / UTM Zone 34N**
Të regjistrohen:

- koordinata X;
- koordinata Y;
- lartësia mbidetare;
- saktësia e matjes.

## 5.6 Matjet dendrometrike

*5.6.1 Matja e diametrit të trungut (DBH)*

Diametri matet në:

1.30 m mbi nivelin mesatar të tokës.

Pajisjet:

- shirit diametri;
- shirit matës;
- kaliper për trungje të vogla.

Rregullat e matjes

**Trungu normal**

Matja bëhet në 1.30 m.

**Trungu me deformime**

Nëse ka:

- zgavra;
- fryrje;
- nyje;
- dëmtime;

matja bëhet në pjesën më të rregullt dhe shënohet vendi i matjes.

**Trungu me disa kërcenj**

Për trungjet me disa kërcenj regjistrohen:

- numri i kërcenjve;
- diametri i secilit;
- diametri mesatar;
- perimetri total.

*5.6.2 Matja e perimetrit*

Perimetri matet në lartësinë 1.30 m.

Formula: Perimetri = Diametri × 3.1416

*5.6.3 Matja e lartësisë*

Metodat:

- hipsometër;
- distancëmatës laser;
- klinometër;
- aplikacione profesionale.

Regjistrohen:

- lartësia totale;
- lartësia e kurorës së parë;
- lartësia e trungut pa degë.

*5.6.4 Matja e diametrit të kurorës*

Matet:

- diametri në drejtimin veri-jug;
- diametri në drejtimin lindje-perëndim.

Formula: Diametri mesatar i kurorës = (V-J + L-P) / 2

**5.7 Identifikimi botanik**

Për çdo trung regjistrohen:

- familja botanike;
- gjinia;
- specia;
- emri shkencor;
- emri shqip;
- emri lokal.

Në raste të pasigurta:

- merret mostër fotografike;
- konsultohet specialisti;
- bëhet verifikim laboratorik sipas nevojës.

**5.8 Vlerësimi i gjendjes shëndetësore**

Gjendja vlerësohet (gjatë periudhës vegjetative) sipas parametrave:

Kurora

Kontrollohen:

- tharja;
- humbja e gjetheve;
- dëmtimet;
- degët e thyera.

Trungu

Kontrollohen:

- çarje;

- zgavra;
- kalbëzim;
- dëmtime mekanike;
- kërpudha.

Rrënjët

Kontrollohen:

- ngritja e tokës;
- dëmtimet;
- ekspozimi;
- stabiliteti.

### 5.9 Vlerësimi i vitalitetit

Sistemi i pikëzimit:

| Nota | Përshkrimi |
|---|---|
| 5 | Gjendje shumë e mirë |
| 4 | Gjendje e mirë |
| 3 | Gjendje mesatare |
| 2 | Gjendje e dobët |
| 1 | Gjendje kritike |

### 5.10 Dokumentimi fotografik

Për çdo trung duhet të realizohen së paku:

1. Fotografimi i përgjithshëm i trungut.
2. Fotografimi i kurorës.
3. Fotografimi i bazës së trungut.
4. Fotografimi i dëmtimeve.
5. Fotografimi i elementeve identifikuese.

Fotografitë duhet të përmbajnë:

- datën;
- kodin e trungut;
- lokacionin;
- drejtimin e fotografimit.

### 5.11 Kontrolli fillestar në terren

Para largimit nga lokacioni ekipi duhet të verifikojë:

- ☐ Formulari është plotësuar
- ☐ Koordinatat janë regjistruar
- ☐ Fotografitë janë realizuar
- ☐ Matjet janë kontrolluar
- ☐ Kodi unik është caktuar

### 5.12 Përfundimi i fazës së terrenit

Pas përfundimit të punës në terren:

- formularët digjitalizohen;
- fotografitë arkivohen;
- koordinatat kontrollohen;
- të dhënat përgatiten për bazën GIS.

Metodologjia e përcaktuar në këtë kapitull siguron që inventarizimi i trungjeve të vjetra të realizohet sipas një procedure të unifikuar, duke garantuar cilësi të lartë të të dhënave dhe bazë profesionale për mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre.

## Shtojca 1.

## FORMULARI STANDARD I INVENTARIZIMIT DHE STRUKTURA E TË DHËNAVE

### Qëllimi

Formulari standard i inventarizimit është instrumenti kryesor për mbledhjen, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave për trungjet e vjetra.
Përdorimi i një formulari unik në të gjitha komunat siguron:

- standardizimin e të dhënave;
- krahasueshmërinë e të dhënave;
- kontrollin e cilësisë;
- integrimin në bazat GIS;
- dokumentimin për procedurat e mbrojtjes ligjore.

Formulari mund të përdoret:

- në format fizik gjatë punës në terren;
- në format digjital përmes aplikacioneve GIS;
- si pjesë e dosjes për shpalljen e Monumentit të Natyrës.

---

### Parimet e plotësimit të formularit

Gjatë plotësimit duhet të respektohen këto parime:

- çdo trung ka një kod unik;
- çdo fushë plotësohet me të dhëna të verifikueshme;
- matjet regjistrohen me njësi standarde;
- fotografitë lidhen me kodin e trungut;
- ndryshimet e mëvonshme dokumentohen;
- të dhënat kontrollohen nga personi përgjegjës.

### Struktura e formularit

Formulari ndahet në 10 seksione kryesore:

1. Të dhënat identifikuese
2. Të dhënat administrative
3. Të dhënat botanike
4. Matjet dendrometrike
5. Gjendja shëndetësore
6. Vlerat ekologjike
7. Vlerat historike dhe kulturore

8. Rreziku dhe kërcënimet
9. Dokumentimi fotografik
10. Vlerësimi për mbrojtje

---

**SEKSIONI 1**
TË DHËNAT IDENTIFIKUESE

| Fusha | Përshkrimi |
|---|---|
| Kodi unik | Kodi identifikues i trungut |
| Data e inventarizimit | Data e punës në terren |
| Inventarizuesi | Emri i personit/ekipit |
| Institucioni | Komuna ose institucioni përgjegjës |
| Statusi | I ri / i verifikuar / i mbrojtur |

Shembull kodi: **KS-PR-001-2026**

- KS – Republika e Kosovës
- PR – kodi i komunës
- 001 – numri rendor
- 2026 – viti i inventarizimit

---

**SEKSIONI 2**
TË DHËNAT ADMINISTRATIVE DHE LOKACIONI

| Fusha | Përshkrimi |
|---|---|
| Komuna | Emri i komunës |
| Zona kadastrale | Njësia kadastrale |
| Vendbanimi | Fshati/qyteti |
| Parcela | Numri kadastral |
| Pronësia | Publike/private |
| Adresa | Për trungjet urbane |
| Lartësia mbidetare | Metra |

---

**SEKSIONI 3**

TË DHËNAT BOTANIKE

| Fusha | Përshkrimi |
|---|---|
| Emri shqip | Emri lokal i pemës |
| Emri shkencor | Specia botanike |
| Familja | Familja botanike |
| Origjina | Autoktone / e introduktuar |
| Gjendja e identifikimit | E sigurt / kërkon verifikim |

---

**SEKSIONI 4**

TË DHËNAT DENDROMETRIKE-

**Matjet bazë**

| Parametri | Njësia |
|---|---|
| Diametri DBH | cm |
| Perimetri | cm |
| Lartësia totale | m |
| Diametri i kurorës Veri-Jug | m |
| Diametri i kurorës Lindje-Perëndim | m |
| Sipërfaqja e përafërt e kurorës | $m^2$ |

**Forma e trungut**

- ☐ Trung i vetëm
- ☐ Trung me disa kërcenj
- ☐ Trung i degëzuar nga baza
- ☐ Trung i dëmtuar
- ☐ Trung me zgavër

---

**SEKSIONI 5**

VLERËSIMI I GJENDJES SHËNDETËSORE

**Vitaliteti**

| Nota | Përshkrimi |
|---|---|
| 5 | Shumë vital |
| 4 | Vital |
| 3 | Mesatar |
| 2 | I dobët |
| 1 | Në gjendje kritike |

**Gjendja e kurorës**

☐ Kurorë e plotë
☐ Hollim i kurorës
☐ Degë të thata
☐ Dëmtime mekanike
☐ Thyerje të mëdha

**Gjendja e trungut**

☐ Pa dëmtime
☐ Çarje
☐ Zgavër
☐ Kalbëzim
☐ Plagë mekanike
☐ Dëmtime nga zjarri

**Gjendja e rrënjëve**

☐ E mirë
☐ E dëmtuar pjesërisht
☐ E ekspozuar
☐ Rrezik stabiliteti

**SEKSIONI 6**

VLERAT EKOLOGJIKE

**Mikrohabitatet**

☐ Zgavër për shpendë
☐ Habitat për insekte
☐ Likene
☐ Myshqe
☐ Kërpudha
☐ Drurë të vdekur në këmbë

**Rëndësia ekologjike**

Vlerësimi:

| Nota | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | E ulët |
| 2 | Mesatare |
| 3 | E lartë |
| 4 | Shumë e lartë |
| 5 | E jashtëzakonshme |

**SEKSIONI 7**

VLERAT HISTORIKE DHE KULTURORE

**Pyetje orientuese: a lidhet trungu me:**

☐ Objekt fetar
☐ Ngjarje historike
☐ Personalitet
☐ Traditë lokale
☐ Monument kulturor
☐ Vendtakim tradicional

Përshkrimi: ----------
---
---
---
---
---

**SEKSIONI 8**

RREZIQET DHE KËRCËNIMET

**Faktorët kërcënues**

- ☐ Ndërtimi
- ☐ Infrastrukturë rrugore
- ☐ Prerje ilegale
- ☐ Dëmtime mekanike
- ☐ Sëmundje
- ☐ Thatësira
- ☐ Ndryshime klimatike
- ☐ Ndërhyrje në rrënjë

**Niveli i rrezikut**

| Nota | Përshkrimi |
|---|---|
| 1 | Pa rrezik |
| 2 | Rrezik i ulët |
| 3 | Rrezik mesatar |
| 4 | Rrezik i lartë |
| 5 | Rrezik kritik |

**SEKSIONI 9**

DOKUMENTIMI FOTOGRAFIK

**Minimumi:**

| Foto | Përshkrimi |
|---|---|
| Foto 1 | Pamje e përgjithshme |
| Foto 2 | Trungu |
| Foto 3 | Baza dhe rrënjët |
| Foto 4 | Kurora |
| Foto 5 | Dëmtimet/mikrohabitatet |

**SEKSIONI 10**

VLERËSIMI PËR MBROJTJE

**Kategoria e propozuar**

☐ Monument natyre me karakter botanik

☐ Trung urban me vlerë të veçantë

☐ Vlerë lokale

☐ Nevojitet monitorim

**Rezultati i pikëzimit**

| Kriteri | Pikët |
|---|---|
| Mosha | /25 |
| Dimensionet | /25 |
| Vlera botanike | /15 |
| Vlera ekologjike | /15 |
| Vlera kulturore | /10 |
| Vlera peizazhore | /10 |
| Totali | /100 |

**Formulari i verifikimit profesional**

Për trungjet që propozohen për mbrojtje duhet të plotësohet edhe:

- raport profesional;
- mendim ekspertësh;

- hartë lokacioni;
- dokumentacion fotografik;
- arsyetim për vlerën e mbrojtjes.

**Struktura e bazës së të dhënave GIS**

Çdo rekord duhet të përmbajë:

| Fusha | Tipi i të dhënës |
|---|---|
| Kodi | Tekst |
| Specia | Tekst |
| X koordinata | Numerike |
| Y koordinata | Numerike |
| DBH | Numerike |
| Lartësia | Numerike |
| Mosha | Numerike |
| Statusi mbrojtës | Tekst |
| Data e inventarizimit | Datë |
| Foto | Lidhje skedari |

**Arkivimi i të dhënave**

Të dhënat duhet të ruhen në:

- server institucional;
- kopje rezervë;
- arkiv elektronik;
- format të standardizuar.

---

Formulari standard është baza e gjithë procesit të inventarizimit. Plotësimi i plotë dhe korrekt i tij siguron që çdo trung i regjistruar të ketë dokumentacion të mjaftueshëm për vlerësim, monitorim dhe mbrojtje.

# Udhëzuesi

## Për Inventarizimin e trungjeve të vjetra si Monumente të natyrës me karakter botanik dhe Monumente të arkitekturës së parkut  në Republikën e Kosovës

Udhëzuesi është  përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës- AMMK.

*Adresa e AMMK-së:*
*Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04*
*Tel. +381 38 200 74 093 , email: ammk@rks-gov.net*
***https://ammk-rks.net/***

Prishtinë, Nëntor 2026